



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
për Persona të Pagjetur dhe Peticione

P-nr.36/2018

Prishtinë, më 26 nëntor 2018

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Lirije Kajtazi, Mirjeta Kalludra, Luljeta Veselaj-Gutaj, Shemsi Syla dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Sasha Milosavljeviq, Mexhide Mjaku-Topalli, Saranda Bogujevci, Fisnik Ismaili dhe Veton Berisha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Selman Ymeri, koordinator dhe Sulltane Gashi, zyrtare e fushës.

Pjesëmarrës të tjerë: Teuta Prekazi-UN Human Rights, Flora Kryeziu-UNICEF, Edon Baliqi-KDI, Zana Ulaj, praktikante, Blendon Arifi, praktikant dhe Sanije Berisha-OSBE.

Mbledhjen e kryesoi, Duda Balje, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës,
2. Të ndryshme.

1. Shqyrtimi i Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës

Kryetarja, tha se ky projektligj ka kaluar leximin e parë në Kuvend. Si komision kemi mbajtur një dëgjim publik, kemi vendosur për mbajtjen e një punëtorie dhe të shikojmë modalitete se si të punojmë më tutje, që të kemi një ligj sa më të mirë. UNICEF-i ka premtuar se do të mbështes mbajtjen e një punëtorie brenda Kosovës.

Teuta Haxhiu, tha se tani kemi një draft përpara me një volum më të madh. Vërtetë na duhet një punëtori me prezencën e të gjithë kolegëve deputetë, që të punohet mirë dhe pa ndërprerje në këtë projektligj. Duhet të kërkohen edhe partnerë të tjerë, që mund të na ndihmojnë që të

jepet kontributi i secilit deputetë. Nuk mund të themi që mund të punojmë shpejt e shpejt, dhe mendoj që në këtë projektligj të punojmë edhe sa i përket qasjes dhe mbrojtjes së fëmijës.

Kemi shumë punë dhe konsideroj që në bashkëpunim me partnerë të tjerë, pse jo edhe UNICEF-i, ta bëjmë një punëtorë funksionale.

Kryetarja, tha se kush është i interesuar të punojë, mund të jetë i pranishëm. Nuk e kemi formuar grupin punues sepse deputetët kanë qenë shumë të interesuar për të punuar të gjithë. Kemi një propozim nga UNICEF-i për mbajtjen e punëtorisë në Prevallë dhe ne duhet të vendosim për datën e mbajtjes.

Mirjeta Kalludra, tha se kudo që mbahet do të jetë aty për të dhënë kontributin në këtë projektligj.

Luljeta Veselaj, tha se për shqyrtimin e këtij projektligji, nuk kemi formuar grup punues, por është mirë të caktohet një kryesues për shkak të mbarëvajtjes së punëve.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni vendosi që punëtorë për shqyrtimin e Projektligjit për Mbrojtjen e Fëmijës të mbahet në Prevallë, dhe ajo do të jetë treditore, përkatësisht më 6-8 dhjetor, por për këtë do të konsultohem me sekretarin e Kuvendit, se si është paraparë mbajtja e seancave plenare, e cila mund të ndikojë në realizimin e punëtorisë.

2. Të ndryshme.

Kryetarja, tha se kohëve të fundit jemi ballafaquar me reduktime të rrymës dhe ne si Komision dhe Kuvend, kemi miratuar edhe rekomandime. Ajo propozoi që të ftohen në mbledhje të radhës të Komisionit, përfaqësues të, ZRRE-së, Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Avokati i Popullit.

Kryetarja, konstatoi, se Komisioni më 3 dhjetor do të mbajë mbledhje për të shënuar ditën ndërkombëtare për personat me aftësi të kufizuara, ko do të ftohen Shoqatat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ZQM-ja si dhe IAP-i.

Kryetarja, po ashtu, propozoi që në lidhje me fushatën për aktivizimin kundër dhunës në baza gjinore, të ftohen në një mbledhje tjetër të Komisionit, Koordinatori Nacional për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Agjencia për Barazi Gjinore, Institucioni i Avokatit të Popullit dhe Shoqatat për Mbrojtjen e të Drejtave të Grave, ku do të diskutohet për dhunën në baza gjinore. Propozimi i lartpërmendur i kryetares u miratua.

Teuta Haxhiu, njoftoi anëtarët e Komisionit Funkcional, se familjarëve të personave të zhdukur në Meje, pas angazhimit të këtij Komisioni, kompania ua ka kthyer fotografitë e familjarëve, dhe për këtë falënderoi anëtarët e Komisionit.

Kryetarja, njoftoi anëtarët e komisionit se dy deputetë nga Parlamenti i Bosnjës, për disa ditë do të jenë në Kosovë dhe njëra prej tyre është anëtare në Komisionin homolog, ndërsa do të qëndrojnë në Prizren. Ajo theksoi se do të takojmë ata për një drekë pune. Ajo ftoi anëtarët e Komisionit të marrin pjesë në këtë takim.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Duda Balje